



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**VENDIM**

**Nr. 492, datë 21.10.2020**

**PËR  
NDËRPRERJEN E MARRËDHËNIEVE NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR  
TË NDIHMËSIT LIGJOR PRANË GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË  
PARË GJIROKASTËR, Z. {...} PËR SHKAK TË DORËHEQJES**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 90, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenit 80, pika 3 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 64, të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në vendimin e tij nr. 424, datë 12.10.2020 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, si dhe në kërkesën për dorëheqje të ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, z. {...}, regjistruar me aktin nr. 4866 prot., datë 05.10.2020,

**VENDOSI:**

1. Ndërprerjen e marrëdhënieve në shërbimin civil gjyqësor, të ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, z. {...}, për shkak të dorëheqjes.
2. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 04.11.2020.
3. Njoftimin e këtij vendimi z. {...}si dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**